



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 19 korrik 2021
Nr. ref.:RK 1818/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI32/21

Parashtrues

Hasan Shala

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme,
AA. nr. 14/2020, të 13 janarit 2021**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Hasan Shala, Kryetar i Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës, në cilësinë e tij si "Autoritet Kompetent" për të iniciuar procedurën disiplinore sipas Ligjit Nr. 06/L - 057 për Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin AA. Nr. 14/2021, të 13 janarit 2021, të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar, përmes të cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale], të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i Kërkesave dhe Përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 9 shkurt 2021, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) pranoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës.
6. Më 11 shkurt 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Safet Hoxha (anëtarë).
7. Më 2 mars 2021, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
8. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe Rregullit 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin 4 të Rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit KK-SP 71-2/21 të Gjykatës, u përcaktua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani, detyrën e Kryetares së Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, më 26 qershor 2021.
9. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe Rregullit 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të Rregullores së Punës, Gjyqtari Bekim Sejdiu paraqiti dorëheqjen e tij nga pozita e gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese.

10. Më 27 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës Arta Rama–Hajrizi, përmes Vendimit Nr. KI32/21, caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi si gjyqtar raportues në vend të Gjyqtarit Bekim Sejdiu.
11. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin 4 të Rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit KK-SP 71-2/21, të 17 majit 2021 të Gjykatës, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.
12. Më 30 qershor 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Më 13 mars 2020, parashtruesi i kërkesës, në cilësinë e Kryetarit të Gjykatës së Apelit, parashtroi në Këshillin Gjyqësor të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: KGJK), kërkesë për fillimin e hetimeve ndaj gjyqtarit Q.A., gjyqtar në Gjykatën e Apelit, me pretendimin se ky i fundit kishte kryer shkelje disiplinore, si rezultat i trajtimit jo të barabartë të palëve. Parashtruesi i kërkesës në mënyrë specifike kishte theksuar se gjyqtari Q.A., në kundërshtim me Strategjinë e KGJK-së për reduktimin e lëndëve të vjetra dhe rekomandimeve të Kolegriumit të gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit, kishte shpërfillur zgjidhjen e lëndëve më të vjetra të vitit 2015, duke zgjidhur lëndë të rëndësisë së njëjtë të viteve 2016, 2017 dhe 2018. Në kërkesën e tij, parashtruesi i kërkesës pretendoi se veprimi i lartcekur i gjyqtarit Q.A. përbënte shkelje të paragrafëve 1 dhe 2 të nenit 7 [Qasja në Gjykata] të Ligjit 06/L-054 për Gjykatat (në tekstin e mëtejme: Ligji për Gjykatat); paragrafit 1, pika 1.3 dhe paragrafit 2, pika 2.7 të nenit 5 [Shkeljet disiplinore për gjyqtarë] të Ligjit Nr. 06/L-057 për Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve (në tekstin e mëtejme: Ligji për Përgjegjësitë Disiplinore); nenin 3.2 të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtarë (në tekstin e mëtejme: Kodi i Etikës); nenin 2.1.4 të Rregullores 04/2016 për Caktimin e Sjelljeve të Pahijshme. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës kërkoi që gjyqtarit Q.A. t'i shqiptohej masë disiplinore.
14. Më 10 prill 2020, KGJK, përmes Vendimit KGJK nr. 72/2020, themeloi Panelin Hetimor për zhvillimin e hetimeve ndaj gjyqtarit Q.A., për shkeljet e pretenduara disiplinore.
15. Më 16 qershor 2020, Paneli Hetimor paraqiti raportin me shkrim përkitazi me hetimin e zhvilluar për shkeljet e pretenduara disiplinore të gjyqtarit Q.A.
16. Më 18 nëntor 2020, KGJK, pas mbajtjes së seancës dëgjimore, përmes Vendimit KGJK. Nr. 262/2020 konstatoi që gjyqtari Q.A., nuk është përgjegjës për shkeljet disiplinore të përcaktuara me nenin 5, paragrafin 1, nënparagrafin 1.3 dhe paragrafin 2, nënparagrafët 2.2 dhe 2.7 të Ligjit për Përgjegjësitë Disiplinore.
17. Në një datë të paspecifikuar, kundër Vendimit të lartcekur të KGJK-së, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën Supreme për shkak: (i) të

shkeljeve esenciale të dispozitave të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore; (ii) vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe (iii) zbatimit të gabuar të drejtës materiale.

18. Më 13 janar 2021, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit AA. Nr. 14/2020 e hodhi si të palejuar ankesën e parashtruesit të kërkesës.
19. Gjykata Supreme, në lidhje me lejueshmërinë e ankesës, iu referua paragrafit 1 të nenit 9 dhe paragrafëve 1 dhe 3 të nenit 15 [Ankesa ndaj vendimeve disiplinore] të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore. Po ashtu, Gjykata Supreme iu referua edhe dispozitave të Rregullores 05/2019 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve (në tekstin e mëtejme: Rregullorja për Procedurën Disiplinore), përkatësisht nenit 2, paragrafit 1, nënparagrafit 1.5.
20. Bazuar në dispozitën e lartcekur të Rregullores për Procedurën Disiplinore, Gjykata Supreme vlerësoi se në *“këtë kontest aktual-Autoriteti Kompetent nuk mund të ketë cilësinë e palës ankuese si subjekt i autorizuar që drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme të Kosovës, të paraqet ankesë për shkak të kufizimeve ligjore lidhur me subjektin që mundë të parashtrojë ankesë kundër vendimeve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Kjo për faktin se nga përmbajtja e dispozitës se cituar, pjesa e përkufizimeve tek neni 2, i, Rregullores për Procedurën Disiplinore rrjedh se palë në tërë procesin disiplinor është vetëm subjekti i hetimit disiplinor, ndërsa subjektet tjera janë palë varësisht nga rrjedha e procedurës disiplinore.”*
21. Tutje, Gjykata Supreme duke iu referuar paragrafit 3 të nenit 15 të Ligjit për Procedurën Disiplinore, theksoi se *“Subjektet e autorizuarra për ushtrimin e drejtës së ankesës varësisht nga interesi juridik për ushtrimin e mjetit të goditjes janë gjyqtari ose prokurori subjekt i hetimit disiplinor, Autoriteti Kompetent, i cili ka kërkuar fillimin e hetimeve dhe Avokati i Popullit për situatën e përcaktuar nën nenin 12 paragrafi 3, të Ligjit. Këta persona kanë të drejtë të paraqesin ankesë në Gjykatën Supreme, vetëm në rastin kur Këshilli nuk merr vendim në përputhje me nenin 14, paragrafi 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Nga përmbajtja e kësaj dispozite ligjore del se Autoriteti Kompetent që ka parashtruar kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore ndaj një gjyqtari mundë të ushtrojë të drejtën e ankesës në Gjykatën Supreme të Kosovës, vetëm në rastin kur Këshilli nuk merr vendim brenda dy (2) muajve nga pranimi i raportit të panelit hetimor (neni 14 par. 6 Ligjit).”*
22. Po ashtu, Gjykata Supreme konstatoi *“se e drejta e Autoritetit Kompetent për ushtrimin e ankesës në Gjykatën Supreme duhet të interpretohet në përputhje me dispozitën e nenit 15, paragrafit 3, të Ligjit, të kufizohet vetëm në situatën kur Këshilli nuk merr vendim përkatës.”*
23. Përfundimisht, Gjykata Supreme kishte vlerësuar se *“... paragrafi 1, i nenit 15 të Ligjit, të lartpërmendur, përcakton të drejtën e shtrimit të ankesës drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme të Kosovës, duke përjashtuar gjykata tjera nga juridiksioni që të vendosin në procedura disiplinore sipas ankesës, dhe nuk përcakton rrethin e subjekteve që kanë të drejtë të ankesës, sepse një gjë të tillë e përcakton paragrafi 3 i nenit 15 të Ligjit të lartpërmendur.”*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

24. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktvendimi i kontestuar i Gjykatës Supreme është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 32 [E Drejta për Mjet Juridik] të Kushtetutës.
25. Parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij thekson se ligji nuk përcakton *“se kush është palë në procedurë, duke ja njohur këtë të drejtë çdo personi fizik dhe juridik (neni 9, paragrafi 1) pra qasja e ligjit është gjeneroze, jo kufizuese dhe e pakushtëzuar.”*
26. Në vijim të kësaj, parashtruesi i kërkesës i referohet edhe paragrafi 1.5 të nenit 2 të Rregullores për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve. Sipas parashtruesit të kërkesës *“Konstatim i Gjykatës Supreme se Autoriteti Kompetent mund të ushtrojë ankesë në Gjykatën Supreme, vetëm në rastet kur Këshilli nuk merr vendime brenda dy muajve, prej datës së pranimi të raportit të panelit hetimor (neni 14, paragrafi 6 i Ligjit), është interpretim subjektiv dhe tërësisht jashtë kontestit i normës juridike.”* Sipas parashtruesit të kërkesës *“[...] kjo normë sikur që shihet, rregullon një situatë të caktuar, pra situatën kur KGJK nuk nxjerr vendim, brenda nja afati të caktuar, duke i lënë mundësi Avokatit të Popullit të ushtroj ankesë, prandaj nuk mund të interpretohet në mënyrë të përgjithësuar për të gjitha rastet, ashtu sikur ka bërë Gjykata Supreme.”*
27. Bazuar në arsyetimin si më sipër, parashtruesi i kërkesës thekson se në rastin e tij është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm në mënyrë të dyfishtë, përkatësisht sipas tij kjo e drejtë është shkelur: (i) *“në raport me palët (interesin e të cilave e mbroj unë në këtë rast si autoritet kompetent), pasi që [Q.A] si bartës i funksionit publik, në kundërshtim me ligjin dhe një ndër parimet më të vjetrat të drejtësisë “I pari për nga koha është i pari për nga e drejta” ka bërë trajtim jo të barabartë të tyre, duke i dhënë përparësi lëndëve të reja, në raport me lëndët e vjetra.”*; dhe (ii) është shkelur *“në raport me mua pasi rasti të cilin e kam inicuar, nuk ka përfunduar në mënyrë meritore, nuk ka marrë një epilog përfundimtar gjyqësor, rreth përgjegjësisë disiplinore të subjektit në fjalë, nga autoriteti gjyqësor i shkallës së dytë.”*
28. Në vijim, parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon se është shkelur e drejta e tij për mjet juridik, e garantuar me nenin 32 të Kushtetutës, për arsye se sipas tij Gjykata Supreme *“në mënyrë arbitrare dhe në kundërshtim me ligjin, [e zhvesh] nga cilësia e palës në procedurë, duke mos i dhënë një epilog gjyqësor kërkesës [së tij] dhe po ashtu është në kundërshtim me “parimin e dy shkallshmërisë”.*
29. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që: (i) të deklarojë kërkesën e tij si të pranueshme; (ii) të konstatojë se ka shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe nenin 32 të Kushtetutës; (iii) të shpallë të pavlefshëm Aktvendimin AA. Nr. 14/2020, të 13 janarit 2021, të Gjykatës

Supreme dhe të njëjtin ta kthejë në rivendosje; dhe (iv) të detyrojë Gjykatën Supreme, që brenda një “afati të caktuar të marr aktvendim meritë lidhur me këtë çështje, përkitazi mbi bazueshmërinë e kërkesës së tij”.

Dispozita relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

Neni 32

[E Drejta për Mjete Juridike]

Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

NENI 6

E drejta për një proces të rregullt

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtojte interesat e drejtësisë.
[...]

LIGJI Nr. 06/L-054 PËR GJYKATAT

Neni 7

Qasja në Gjykata

1. Gjykatat trajtojnë të gjithë personat në mënyrë të barabartë, askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë,

mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare apo shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, gjendjes sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.

2. Çdo person ka qasje të barabartë në gjykata dhe askujt nuk i mohohet e drejta në gjykim të drejtë në përputhje me procedurën e rregullt ligjore ose të drejtë në mbrojtje të barabartë me ligj. Çdo person fizik apo juridik ka të drejtë në gjykim të drejtë dhe brenda afatit të arsyeshëm kohor.

LIGJI Nr. 06/L-057 PËR PËRGJEGJËSINË DISIPLINORE TË GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

Ky ligj përcakton shkeljet disiplinore, procedurat për fillimin e hetimeve për dyshimet për shkelje disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, procedurat disiplinore pranë Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës, sanksionet disiplinore dhe mjetet juridike që lidhen me shkeljet disiplinore pranë Gjykatës Supreme.

Neni 2

Përkufizimet

1. Fjalët e mëposhtme kanë kuptimin si në vijim:

1.1. Autoritet Kompetent - nënkupton Kryetarët e Gjykatave, Kryetarin e Gjykatës Supreme, Kryeprokurorin e Shtetit, Kryeprokurorët dhe Këshillat si autoritete kompetente për pranimin e ankesave ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve për shkeljet e supozuara disiplinore sipas nenit 9, paragrafi 1;

[...]

Neni 5

Shkeljet disiplinore për gjyqtarë

1. Gjyqtari kryen shkelje disiplinore nëse ai ose ajo:

1.1. dënohet për një vepër penale;

1.2. shkel ligjin, ose 1.3. shkel detyrat e tij zyrtare si gjyqtar.

2. Shkelje e detyrave të gjyqtarit, sipas këtij ligji, përfshin veprimet e mëposhtme, në qoftë se gjyqtari i kryen me dashje ose nga pakujdesia e rëndë:

2.1. kryen detyra zyrtare duke mos respektuar parimin e pavarësisë dhe paanshmërisë gjyqësore duke vepruar me paragjykime në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike dhe sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal të palës në procedurë;

2.2. nuk i trajton siç kërkohet me ligj palët në procedurë, përfaqësuesit e tyre, dëshmitarët, dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurë;

- 2.3. u komunikon personave të paaautorizuar informata jo-publike të marra gjatë kryerjes së detyrës zyrtare;
- 2.4. pranon çfarëdo lloj dhurate ose shpërblimi që mund të çojë ose duket se çon në ndikim të paligjshëm në vendimet dhe veprimet zyrtare;
- 2.5. keqpërdor pozitën zyrtare në çfarëdo forme për përfitime të paligjshme për veten ose personat e tjerë ose për qëllime tjera në kundërshtim me ligjin;
- 2.6. nuk raporton rastet e përjashtimit të mundshëm nga procedura kur kërkohet me ligj;
- 2.7. në vazhdimësi nuk i kryen detyrat zyrtare me kohë, siç kërkohet me ligj;
- [...]

KAPITULLI III ANKESAT, HETIMET, DHE PROCEDURA DISIPLINORE

Neni 9

Ankesat ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve për shkelje disiplinore

1. Personat fizik dhe juridik mund të ushtrojnë ankesë ndaj një gjyqtari ose prokurori lidhur me ndonjë pretendim për shkelje disiplinore tek autoritetet vijuese (në tekstin e mëtejshëm: "Autoriteti Kompetent"):
 - 1.1. Kryetari i Gjykatës Themelore dhe të Apelit në të cilën shërben gjyqtari për sa i përket pretendimeve për shkeljeve disiplinore të atij gjyqtari;
 - 1.2. Kryetari i Gjykatës Supreme për sa i përket pretendimeve për shkeljeve disiplinore të Kryetarëve të Gjykatave Themelore dhe Kryetarit të Gjykatës së Apelit;
 - 1.3. Këshilli Gjyqësor i Kosovës për sa i përket pretendimeve për shkelje disiplinore të Kryetarit të Gjykatës Supreme;
 - 1.4. Kryeprokurori i Shtetit për sa i përket pretendimeve për shkelje disiplinore të Kryeprokurorëve;
 - 1.5. Kryeprokurori për sa i përket pretendimeve për shkelje disiplinore të prokurorëve të punësuar në prokurorinë për të cilën është përgjegjës Kryeprokurori.
 - 1.6. Këshilli Prokurorial i Kosovës për sa i përket pretendimeve për shkeljeve disiplinore të Kryeprokurorit të Shtetit.
 2. Kur ankesa i dërgohet autoritetit jokompetent, autoriteti i tillë do të transferojë ankesën tek autoriteti kompetent, në pajtim me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative.
 3. Personat fizik dhe juridik mund të ushtrojnë ankesë ndaj një gjyqtari ose prokurori tek Avokati i Popullit.
- [...]

Neni 12
Procedura hetimore

1. Këshilli fillon procedurat disiplinore mbi bazën e kërkesës të dorëzuar në përputhje me nenin 9, paragrafin 1 të këtij Ligji.
2. Autoriteti Kompetent kërkon nga Këshilli fillimin e hetimeve disiplinore mbi bazën e një ankese të paraqitur nga një person fizik apo juridik dhe e cila nuk është hedhur poshtë sipas nenit 9, paragrafit 6 të këtij Ligji, ose sipas detyrës zyrtare kur ka bazë të arsyeshme të besoj se një gjyqtar ose prokuror ka kryer shkelje disiplinore.
3. Avokati i Popullit mund të kërkojnë nga Këshilli që të filloj hetimet disiplinore ndaj një Kryetari të Gjykatës ose Kryeprokurorit nëse kanë arsye të besojnë se ai/ajo ka kryer shkelje disiplinore sipas nenit 9, paragrafit 7 i këtij Ligji. Në rast të pranimi të ankesës Avokati i Popullit gjithashtu mund të kërkojnë nga Këshilli fillimin e hetimeve disiplinore ndaj një gjyqtari ose prokurori nëse konsiderohet se Autoriteti Kompetent ka marrë vendim për hedhjen poshtë të ankesës ndaj atij gjyqtari ose prokurori në kundërshtim me nenin 9, paragrafin 5, me ç' rast ai/ajo duhet të ofrojnë arsyetim se pse ankesa nuk duhet të ishte hedhur poshtë.

[...]

Neni 14
Procedurat Disiplinore

1. Pas pranimi të raportit me shkrim mbi hetimin e gjyqtarit apo të prokurorit, apo të pranimi të marrëveshjes bazuar në nenin 13 të këtij Ligji, Këshilli respektiv do të mbajë seancë në periudhën kohore prej tridhjetë (30) ditësh. Këshilli mund të vendos të mbajë seanca shtesë në qoftë se një gjë e tillë rrjedh nga kompleksiteti i lëndës. Palët në procedurë do të ftohen të marrin pjesë në seancat e Këshillit.
2. Gjyqtari apo prokurori kundër të cilit zhvillohet procedura disiplinore ka të drejtë të përfaqësojë veten apo të angazhojë avokat mbrojtës. Këshilli obligohet t'i ofrojë qasje në të gjitha provat e mbledhura si dhe në të gjitha dosjet e lëndës.
3. Këshilli vendos nëse është kryer shkelja e supozuar disiplinore dhe, në rast se konstaton se gjyqtari ose prokurori ka kryer shkeljen e supozuar disiplinore, shqipton sanksionin disiplinor sipas dispozitave të këtij Ligji.
4. Kuorumi për procedurë disiplinore do të përbehet nga nëntë (9) anëtarë të Këshillit, dhe vendimet e Këshillit merren me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm.
5. Vendimi i Këshillit duhet të jetë në formë të shkruar dhe të përmbajë arsyet mbi vendimin dhe këshillën juridike. Një kopje e vendimit i dërgohet Autoritetit Kompetent që ka kërkuar fillimin e hetimeve dhe gjyqtarit ose prokurorit, dhe në rastet e parapara me nenin 12 par.3 të këtij ligji Avokatit

të Popullit. Vendimi i shkallës së parë do të publikohet në faqe të Këshillit, pasi të bëhet i formës së prerë.

6. Këshilli merr vendim brenda dy (2) muajve nga pranimi i raportit të panelit hetimor.

Neni 15

Ankesa ndaj vendimeve disiplinore

1. Palët kanë të drejtë të ankohen ndaj vendimeve disiplinore të Këshillit, drejtpërdrejt në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimi të vendimit. Gjykatat tjera në Kosovë, nuk kanë kompetencë të shqyrtojnë dhe të vendosin lidhur me procedurën disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve.

2. Ankesa ndaj vendimit të Këshillit ka efekt suspensiv dhe ndalon implementimin e atij vendimi, derisa të shqyrtohet ankesa.

3. Në rast se Këshilli nuk merr vendim në përputhje me nenin 14, paragrafin 6, gjyqtari apo prokurori dhe Autoriteti Kompetent i cili ka kërkuar fillimin e hetimeve, si dhe në rastet e parapara me nenin 12 par.3 të këtij Ligji, Avokati i Popullit, mund të ushtrojnë ankesë pranë Gjykatës Supreme për mosveprim nga ana e Këshillit përkatës.

4. Ankesë mund të ushtrohet në rrethanat si në vijim:

4.1. në rast të zbatimit të gabuar të ligjit;

4.2. në rast të shkeljes procedurale të përcaktuar me ligj;

4.3. në rast të një gabimi faktik të qartë apo të dukshëm i cili ndikon në të drejtat substanciale të palës në qoftë se ndikon seriozisht në paanësinë dhe integritetin e procedurës;

5. Gjykata Supreme, në një trup gjykues të përbërë nga tre anëtarë, të zgjedhur nga Kryetari i Gjykatës Supreme, brenda tridhjetë (30) ditëve, shqyrton dhe vendos lidhur me ankesën. Në rast se Kryetari i Gjykatës Supreme është subjekt i vendimit të Këshillit, atëherë zgjedhjen e anëtareve e bën gjyqtari më i moshuar i Gjykatës Supreme.

6. Pas shqyrtimit të ankesës, Gjykata Supreme mund të konfirmojë vendimin e Këshillit, ta ndryshojë atë, apo ta kthejë në Këshill për rishqyrtim.

7. Në rast se Gjykata Supreme vendos ta kthejë çështjen për rishqyrtim në Këshill, atëherë Këshilli vendos brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e marrjes së vendimit, sipas vendimit të Gjykatës, si dhe njofton Gjykatën me shkrim. 8. Në rast se Gjykata Supreme nuk merr njoftim brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e kthimit të rastit për rishqyrtim siç parashihet në paragrafin 6, atëherë Gjykata Supreme vendos mbi rastin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve. 9. Vendimi i Gjykatës Supreme është përfundimtar. 10. Përbërja e trupit gjykues pranë Gjykatës Supreme sipas paragrafit 5 të këtij neni dhe ai i panelit hetimor sipas nenit 12, paragrafi 5, nuk duhet të përbehet nga anëtarët të cilët janë subjekt i procedurave disiplinore.

Rregullore 05/2019 e Këshillit Gjyqësor të Kosovës për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve

Neni 2 Përkufizimet

- 1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin si në vijim:*
 - 1.1 Autoritet Kompetent - nënkupton Kryetaret e Gjykatave, Kryetarin e Gjykatës Supreme, dhe Këshillin Gjyqësor të Kosovës si Autoritet Kompetent për pranimin e ankesave ndaj gjyqtarëve për shkeljet e supozuara disiplinore sipas nenit 9, paragrafi 1 të Ligjit;*
 - 1.2 Këshilli - nënkupton Këshillin Gjyqësor të Kosovës;*
 - 1.3 Kryetar i Gjykatës - nënkupton Kryetarin e Gjykatës Themelore, Kryetarin e Gjykatës së Apelit, dhe Kryetarin e Gjykatës Supreme;*
 - 1.4 Vepër e rëndë penale - nënkupton veprat penale të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.*
 - 1.5 Palë në procedurë disiplinore, është subjekt i hetimit disiplinor. Në varësi të rrjedhës së procedurës disiplinore palë janë: Parashtruesi i ankesës, Kryetari i Gjykatës, Këshilli dhe Avokati i Popullit.;*

Neni 8 Kërkesa për Fillimin e Hetimit

- 1. Nëse autoriteti kompetent (Kryetari i Gjykatës) konstaton se ankesa është e bazuar ose pretendon se ka shkelje disiplinore, i'a paraqet Këshillit kërkesën për fillimin e hetimeve.*
- 2. Autoriteti kompetent mund të kërkojë nga Këshilli fillimin e hetimeve nda një gjyqtari sipas detyrës zyrtare nëse konsideron se ka bazë të arsyeshme të besoj se një gjyqtar ka kryer shkelje disiplinore.*
- 3. Kërkesa për fillimin e hetimeve duhet të i përmbajë këto elemente:*
 - a. identitetin e gjyqtarit që do të hetohet,*
 - b. përshkrim sa më të saktë të aspekteve faktike dhe juridike mbi të cilat është ngritur dyshimi për shkelje disiplinore,*
 - c. propozim për shqiptimin e masës disiplinore në përputhje me ligjin,*
 - d. përshkrim të saktë të veprimeve të ndërmarra nga Kryetari, si dhe të gjitha shkresat, deklaratat e palëve ose provat eventuale të mbledhura gjatë fazës së shqyrtimit fillestar, e. datën e dorëzimit.*
- 4. Autoriteti kompetent, në momentin kur i'a dorëzon Këshillit kërkesën për hetim, njëkohësisht e informon edhe gjyqtarin i cili është subjekt i hetimit.*

Neni 22 Ankesa ndaj Vendimeve Disiplinore

- 1. Palët kanë të drejtë të paraqesin ankesë ndaj vendimeve disiplinore të Këshillit drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme të Kosovës. Ankesa duhet të parashtrohet brenda 15 ditëve nga dita e pranimin të vendimit të Këshillit.*
- 2. Palët, përfshire, gjyqtarin, autoritetin kompetent dhe Avokati i Popullit kanë të drejtë të paraqesin ankesë kundër Këshillit për mosveprim drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme, ankesa parashtrohet dy (2) muaj nga data kur Këshilli e pranon raportin e panelit hetimor.*

3. Ankesa ndaj vendimit të Këshillit e suspendon dhe e shtynë implementimin e tij deri në nxjerrjen e vendimit nga Gjykata Supreme.
4. Gjykata Supreme, në trup gjykues prej tre (3) anëtarëve të zgjedhur nga Kryetari i Gjykatës Supreme, vendos brenda tridhjetë (30) dite për ankesën në bazë të parashtrësave të dorëzuara me shkrim.
5. Përbërja e trupit gjykues të Gjykatës Supreme nuk duhet të përbëhet nga anëtarët që janë subjekt të procedurave disiplinore.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

30. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
31. Në këtë drejtim, Gjykata fillimisht i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

32. Në vazhdim, Gjykata i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit dhe rregullit 39 (1) (a) të Rregullores së Punës, të cilët përcaktojnë:

Neni 47 [Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Rregulli 39 [Kriteret e Pranueshmërisë]

(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

(a) kërkesa parashtrohet nga një palë e autorizuar,

[...],”

33. Duke iu referuar dispozitave të lartpërmendura, Gjykata fillimisht duhet të konstatojë nëse parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar për të parashtruar kërkesën e tij në kuptim të dispozitave të lartcekura të Kushtetutës, Ligjit dhe Rregullores së punës.
34. Në rastin konkret, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës, në cilësinë e Kryetarit të Gjykatës së Apelit dhe njëkohësisht në cilësinë e autoritetit kompetent sipas dispozitave të Ligjit për Përgjegjësitë Disiplinore, më 13 mars 2020 kishte parashtruar në KGJK kërkesë për fillimin e hetimeve ndaj gjyqtarit Q.A., gjyqtar në Gjykatën e Apelit, me pretendimin se ky i fundit kishte kryer shkelje disiplinore, si rezultat i trajtimit jo të barabartë të palëve. Sipas shkresave të lëndës, të dorëzuara nga parashtruesi i kërkesës, Gjykata vëren se procedura e fillimit të hetimeve ndaj gjyqtarit Q.A., ishte iniciuar sipas detyrës zyrtare nga parashtruesi i kërkesës, pa pasur ndonjë kërkesë specifike të palëve tjera për një procedurë të tillë (paragrafi 2 i nenit 12 [Procedura Hetimore] të Ligjit për Përgjegjësitë Disiplinore). Më 10 prill 2020, KGJK kishte themeluar Panelin Hetimor për zhvillimin e hetimeve ndaj gjyqtarit Q.A., për shkeljet e pretenduara disiplinore, i cili panel më 16 qershor 2020 kishte paraqitur raportin me shkrim përkitazi me hetimin e zhvilluar ndaj gjyqtarit Q.A. KGJK pas mbajtjes së seancës dëgjimore, përmes Vendimit KGJK. Nr. 262/2020, të 18 nëntorit 2020, kishte konstatuar që gjyqtari Q.A nuk ishte përgjegjës për shkeljet disiplinore të përcaktuara me nenin 5, paragrafin 1, nënparagrafin 1.3 dhe paragrafin 2, nënparagrafët 2.2 dhe 2.7 të Ligjit për Përgjegjësitë Disiplinore.
35. Më tutje, Gjykata sjellë në vëmendje se parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar ankesë në Gjykatën Supreme, kundër Vendimit të lartcekur të KGJK-së, për shkak: (i) të shkeljeve esenciale të dispozitave të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore; (ii) vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike; dhe (iii) zbatimit të gabuar të drejtës materiale. Më 13 janar 2021, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit AA. Nr. 14/2020 e hodhi si të palejuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, me arsyetimin se parashtruesi i kërkesës nuk ishte palë e autorizuar për të parashtruar ankesë në këtë gjykatë. Gjykata Supreme iu referua nenit 2; paragrafit 1 të nenit 9; paragrafëve 1 dhe 3 të nenit 15 [Shkeljet disiplinore për gjyqtarë] të Ligjit për Përgjegjësitë Disiplinore; dhe nenit 2, paragrafit 1, nënparagrafit 1.5 të Rregullores për Procedurën Disiplinore, duke konstatuar se palë në procedurë është vetëm subjekti i hetimit disiplinor, përkatësisht gjyqtari Q.A., ndaj të cilit është iniciuar procedura hetimore dhe ajo disiplinore. Gjykata Supreme sqaroi se parashtruesi i kërkesës do të kishte të drejtë të paraqesë ankesë në Gjykatën Supreme vetëm në rastin kur KGJK nuk merr vendim brenda dy (2) muajve nga pranimi i raportit të panelit hetimor. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme konstatoi se, pasi që KGJK kishte nxjerrë Vendimin e saj të 18 nëntorit 2020, parashtruesi i kërkesës nuk ishte palë e autorizuar që të ushtrojë ankesë në Gjykatën Supreme.
36. Parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij para Gjykatës Kushtetuese konteston konstatimin e lartcekur të Gjykatës Supreme, duke pretenduar shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 32 [E Drejta për Mjet Juridik] të Kushtetutës.

37. Ashtu siç është paraqitur më lart, Gjykata vë në dukje se procedura për iniciimin e procedurës së hetimeve ndaj një gjyqtari është e përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Përgjegjësitë Disiplinore dhe Rregullores për Procedurën Disiplinore. Në këtë kontekst, duke iu referuar nenit 2 të Ligjit për Përgjegjësitë Disiplinore dhe nenit 2 të Rregullores për Procedurën Disiplinore, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës në procedurën e zhvilluar disiplinore ndaj gjyqtarit Q.A., kishte cilësinë e Autoritetit Kompetent.
38. Në ndërlidhje me këtë, Gjykata rikujton se procedurat e ankesës kundër Vendimeve të KGJK-së janë përcaktuar në nenin 15 të Ligjit për Përgjegjësitë Disiplinore dhe nenit 22 të Rregullores për Procedurën Disiplinore.
39. Në lidhje me të lartcekurat, Gjykata rikujton arsyetimin e Gjykatës Supreme, e cila përmes Aktvendimit të saj kishte vlerësuar dhe konstatuar si në vijim: *"[...] në këtë kontest aktual-Autoriteti Kompetent nuk mund të ketë cilësinë e palës ankuese si subjekt i autorizuar që drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme të Kosovës, të paraqet ankesë për shkak të kufizimeve ligjore lidhur me subjektin që mundë të parashtrojë ankesë kundër vendimeve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Kjo për faktin se nga përmbajtja e dispozitës se cituar, pjesa e përkufizimeve tek neni 2, i, Rregullores për Procedurën Disiplinore rrjedh se palë në tërë procesin disiplinor është vetëm subjekti i hetimit disiplinor, ndërsa subjektet tjera janë palë varësisht nga rrjedha e procedurës disiplinore."*
40. Gjykata Supreme më tej arsyetoi se *"Subjektet e autorizuarra për ushtrimin e drejtës së ankesës varësisht nga interesi juridik për ushtrimin e mjetit të goditjes janë gjyqtari ose prokurori subjekt i hetimit disiplinor, Autoriteti Kompetent, i cili ka kërkuar fillimin e hetimeve dhe Avokati i Popullit për situatën e përcaktuar nën nenin 12 paragrafi 3, të Ligjit. Këta persona kanë të drejtë të paraqesin ankesë në Gjykatën Supreme, vetëm në rastin kur Këshilli nuk merr vendim në përputhje me nenin 14, paragrafi 6 të Ligjit për Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Nga përmbajtja e kësaj dispozite ligjore del se Autoriteti Kompetent që ka parashtruar kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore ndaj një gjyqtari mundë të ushtrojë të drejtën e ankesës në Gjykatën Supreme të Kosovës, vetëm në rastin kur Këshilli nuk merr vendim brenda dy (2) muajve nga pranimi i raportit të panelit hetimor (neni 14 par. 6 Ligjit)."*
41. Rrjedhimisht dhe bazuar në si më sipër, Gjykata duhet të vlerësoj nëse parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar që të parashtroj kërkesë individuale në Gjykatë Kushtetuese, përkatësisht të vlerësoj nëse parashtruesi i kërkesës ka statusin e viktimës së shkeljeve të drejtave dhe lirive të tij të garantuara me Kushtetutë, ashtu siç është përcaktuar me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës.
42. Në këtë kontekst, Gjykata i referohet edhe praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ) e cila ka konstatuar se *"fjala viktimë në kontekst të nenit 34 të KEDNJ-së nënkupton personin ose personat e prekur në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthortë nga shkelja e pretenduar, por edhe viktimën e tërthortë të cilit shkelja do të shkaktonte dëm ose do të kishte një interes legjitim apo personal që kjo shkelje*

të kryhej” (shih rastin e GJEDNJ-së *Vallianatos the të tjerët kundër Greqisë* [DHM], Aktgjykim, i 7 nëntorit 2013, paragrafi 47).

43. Sipas GJEDNJ, “*nocioni “viktimë”* është interpretuar në mënyrë autonome dhe pavarësisht nga rregullat vendore siç janë ato të të pasurit interes apo mundësinë për të ndërmarrë veprime (shih rastin e GJEDNJ-së, *Gorraiz Lizarraga dhe të tjerët kundër Spanjës*, kërkesa nr. 62543/00, Aktgjykim, i 27 prilli 2004, paragrafi 35; shih edhe rastin e Gjykatës, KI34/20, parashtrues *Ramadan Zogaj*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 10 nëntorit 2020, paragrafi 80) edhe pse Gjykata duhet të ketë parasysh faktin që parashtruesi ka qenë palë në procedurë në gjykatat vendore “ (shih rastin *Aksu kundër Turqisë* [DHM], Aktgjykim, i 15 korrikut 2012, paragrafi 52; *Micallef kundër Maltës* [DHM], Aktgjykim, i 15 tetorit 2009, paragrafi 48; *Bursa Barosu Başkanlığı dhe të tjerët kundër Turqisë*, Aktgjykim, i 19 qershorit 2018, paragrafët 109-117). Për më tepër, dhe relevante për rrethanat e rastit konkret, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, termi “viktimë”, në kontekst të kërkesave individuale, nënkupton personat që janë afektuar në mënyrë direkte ose indirekte nga shkelja e pretenduar.
44. Bazuar në shkresat e lëndës, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij pretendon shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, për arsye se si rezultat i mosshqyrtimit të ankesës së tij në merita nga Gjykata Supreme palëve të treta u janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton se kërkesa në Gjykatën Kushtetuese është paraqitur nga parashtruesi i kërkesës, në cilësinë e autoritetit kompetent në bazë të Ligjit për Procedurën Disiplinore. Rrjedhimisht, sipas shkresave të lëndës nuk rezulton që iniciimi i procedurës së hetimeve ndaj gjyqtarit Q.A., është rezultat i kërkesave apo ankesave të palëve të treta, por e njëjta është iniciuar sipas detyrës zyrtare nga parashtruesi i kërkesës.
45. Gjykata vlerëson se në këtë procedurë nuk është vendosur në lidhje me të drejtat dhe liritë individuale të parashtruesit të kërkesës të garantuara me Kushtetutë. Si rrjedhojë, Gjykata bazuar në elaborimin si më sipër arrin në përfundim se parashtruesi i kërkesës nuk e ka cilësinë e viktimës, të cilit shkelja do ti shkaktonte dëm ose do të kishte një interes legjitim dhe personal që kjo shkelje të përfundonte.
46. Prandaj, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk është palë e autorizuar, ashtu siç përcaktohet me paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës dhe rregullit 39 (1) (a) të Rregullores së punës, që të paraqesë kërkesë kundër një Aktvendimi, i cili është nxjerrë në procedurë ku parashtruesi i kërkesës nuk është konsideruar si palë e autorizuar procedurale dhe përmes së cilës nuk është vendosur lidhur me të drejtat e tij.
47. Si përfundim, Gjykata, në pajtim me paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës dhe rregullit 39 (1) (a) të Rregullores së punës, konstaton se kërkesa e parashtruesit duhet të shpallet e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (a) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 30 qershor 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Nexhmi Rexhepi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Gresa Caka-Nimani